



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.771/14 prot.

Datë 20.05.2026

V E N D I M
Nr.677/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.05.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 530/2026, datë 22.04.2026 për procedurën e prokurimit, “E hapur, e thjeshtuar”, me objekt “Shpenzime për aktivitete social-kulturore dhe sportive të vitit”, me nr. REF-76028-02-12-2026, fond limit 3,859,800.00 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 27-02-2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Roskovec

Ankimues:

Operatori ekonomik “Besim Kamberi” pf, me NIPT LJ61817047D, me adresë: Rruga e Qelqit, Kashar.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Roskovec.
Adrese: Fier, Lagjia nr. 1

Subjekte të Interesuara:

Operatori ekonomik “Arteo 2018” sh.p.k, me NIPT L82523203F, me adresë: Lagjia “Luigj Gurakuqi”, Bulevardi Aqif Pasha, Hotel Skampa, kati 5 nr.303.

Operatori ekonomik “Bregu Company” sh.p.k me NIPT L82729403H, me adresë: Fier, Patos, Fshati

Zharrez, Bashkia Patos, Zona Kadastrale nr. 3922,
Nr. Pasurie 83/209.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 22.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 530/2026, ku vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Besim Kamberi” pf për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me objekt “Shpenzime për aktivitete social-kulturore dhe sportive të vitit”, me nr. REF-76028-02-12-2026, fond limit 3,859,800.00 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 27-02-2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Roskovec.*
2. *Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me objekt “Shpenzime për aktivitete social-kulturore dhe sportive të vitit”, me nr. REF-76028-02-12-2026, fond limit 3,859,800.00 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 27-02-2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Roskovec.*
3. *Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 (pesë) ditëve duke dokumentuar çdo veprim të tij.*
4. *Operatori ekonomik ankimes “Besim Kamberi” pf të zbatojë parashikimet e pikës 3/c të nenit 118 “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.*
5. *Të marrë masën administrative gjorbë në masën 100,000 (qind mijë) lekë për Znj. Majlinda Bufi, Titullar i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Roskovec.*
6. *Kjo gjorbë përbën titull ekzekutiv.*

7. *Kundër vendimit për marrjen e masës administrative (gjobë) mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, në përputhje me Ligjin nr. 10279 datë 20.5.2009 “Për kundërvajtjet administrative”.*
8. *Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
9. *T’i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ për konstatimet e mësipërme, si edhe të dërgohet pranë APP-së kopje e materialeve të administruara në shqyrtimin administrativ nr. 771 prot., datë 11.03.2026.*
10. *Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Monitorimit Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror.*
11. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr. 3432 prot., datë 08.05.2026, protokolluar me tonën nr. 771/6 prot., date 11.05.2026, autoriteti kontraktor, Bashkia Roskovec, njofton se ka bërë zbatimin e vendimit per procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, REF-76028-02-12-2026, fond limit 3,859,800.00 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 27-02-2026 si dhe gjithashtu në vijim autoriteti kontraktor kërkon heqjen e pezullimit për procedurë objekt ankimi.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 3432 prot., datë 08.05.2026, protokolluar me tonën nr. 771/6 prot., date 11.05.2026, autoriteti kontraktor, Bashkia Roskovec, njofton se ka bërë zbatimin e vendimit per procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, REF-76028-02-12-2026, fond limit 3,859,800.00 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 27-02-2026 si dhe gjithashtu në vijim autoriteti kontraktor kërkon heqjen e pezullimit për procedurë objekt ankimi.

II.2. Referuar shkresës nr. 3432 prot., datë 08.05.2026, protokolluar me tonën nr. 771/6 prot., date 11.05.2026, si dhe pas verifikimeve të përmbajtjes së saj rezulton se dokumentacioni i përcjellë në KPP është kopje dhe për më tepër rezulton i pa vulosur, si dhe nuk është njësuar me origjinalin. Referuar parashikimeve të nenit 49, nenit 99 të ligjit n. 44/2025 “Kodi i Procedurave Administrative” rezulton se dokumentacioni i përcjellë në Komisionin e Prokurimit Publik nuk përmbush, kërkesat e formës së aktit administrativ të shkruar në letër.

II.3. Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se autoriteti kontraktor Bashkia Roskovec, nuk ka zbatuar vendimin Nr. 530/2026 datë 22.04.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit nr. REF-76028-02-12-2026, fond limit 3,859,800.00 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 27-02-2026.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me objekt “Shpenzime për aktivitete social-kulturore dhe sportive të vitit”, me nr. REF-76028-02-12-2026, fond limit 3,859,800.00 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 27-02-2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Roskovec.
 2. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

